



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHKETËSE

Tiranë, më 15.04.2024

NJOFTIM PUNËSIMI

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, si dhe në VKM nr. 39, datë 24.01.2024, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024, në njësitë e qeverisjes qendrore”,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall njoftimin e punësimit për vendet e pa plotësuar si më poshtë vijon :

II. DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHKETËSE

- **SANITAR** (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë)

- **Detyrat kryesore:**
 - Të pastrojë dhe të mirëmbajë sipërfaqet e zyrave, korridoreve, shkallëve të godinës si dhe ambientet e jashtme që janë në administrim të AZHBR;
 - U përgjigjet kërkesave shtesë të punonjësve për sa i përket sektorit të pastrimit dhe mirëmbajtjes;
 - Kujdeset për mirëmbajtjen në gjendje pune të të gjitha pajisjeve/mjeteve të shërbimit.

- **Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:**
 1. Të kenë mbaruar arsim profesional / arsim i mesëm.
 2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
 3. Të kenë përvojë pune të mëparshme.

- **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**
 - Ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
 - Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
 - VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 17.04.2024, ora 16.30 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjollështa”, Nr. 56, Tiranë):

Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL